



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 423 / Prot.
01

Tiranë, më 18 . 04 . 2023

AKT PËRPUTHSHMËRIE
PËR DOKUMENTIN E RISHIKIMIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA VORË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 dhe pikës 3 të nenit 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, të Vendimit Nr. 3, datë 17.05.2019 të KKT-së "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Vorë", të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit, të dhënave elektronike bazë, si dhe Raportit të Vlerësimit Teknik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, bashkia Vorë.
2. Akti i përputhshmërisë lëshohet me kusht që, përpara miratimit të dokumentit të rishikimit në Këshillin Kombëtar të Territorit, bashkia:
 - a) të presë qëndrimin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (se rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor nuk ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të VSM-së), në zbatim të Ligjit Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor";
 - b) të presë qëndrimin konfirmues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për ndryshimet e propozuara në njësitë strukturore me kode: VO_UB_A2_5-5, VO_UB_S2_1-16, VO_UB_S_2-26; VO_UB_A2_3-4, VO_UB_A1_3-121 dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për ndryshimet e propozuara në njësitë strukturore me kod: VO_N_N1_1-38.

ADELENA GRICA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT